



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 3324 / _____ Prot

Tiranë, më __, __, 2020

LËNDA: *Modifikim në DST të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin situatës së Covid-19” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej 599,940,000 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH.*

DREJTUAR: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIKË TË INTERESUAR

PËR DIJENI: AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Autoriteti Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale njofton se bëhet modifikimi si më poshtë:

I. Në Shtojcën 9, pik II të DST “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të procedurës së sipërcituar bëhet ndryshimi i mëtejshëm si më poshtë vijon:

ISHTE:

5. *Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar.*

BËHET:

5. *“Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar) ose sipas normës EU 2016/425, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre përkatës, të përkthyer dhe të noterizuar.*

II. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike”, dhe në Shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, specifikimi teknik për artikullin nr.2 Doreza Nitrili ndryshon si më poshtë vijon:

ISHTE:

“sterile, pa puder ngjyre blu ose lejla me trashësi 0.12 mm (kuti me 100 cope), duhet të jenë me të trasha se sa normalet për punë në laborator Masa M” - Njësia “Kuti”

Sasia totale 12 muaj: 80 kuti

BËHET:

“sterile, pa puder ngjyre blu ose lejla me trashesi me diapazon 0.1 mm - 0.12 mm, duhet te jene me te trasha se sa normalet per pune ne laborator Masa M” - Njësia “Copë”

Sasia totale 12 muaj: 8000 cope

III. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike”, dhe në Shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimet” specifikimi teknik për artikullin nr.7 Kostum veshje spitalore (veshje komplet me kapuc, kominoshe tyvek me masa XL dhe L) bëhet ndryshimi i mëtejshëm si më poshtë vijon:

ISHTE:

“Veshje komplet me kapuc (kominoshe-tyvek) me masa XL dhe L”

BËHET:

“Veshje komplet me kapuc (kominoshe-tyvek ose ekuivalent) me masa XL dhe L. “

IV. Afati kohor për dorëzimin e ofertave në sistemin elektronik:

ISHTE:

28.08.2020 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

BËHET

08.09.2020 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Shenim: Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje janë shqip ose anglisht

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Gelardina Prodani